



KOMUNA GURI I ZI



PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË KOMUNËS GURI I ZI

P ë r m b l e d h j e

Përgatitur nga: KOMUNA GURI I ZI

Mbështetur nga: Intercooperation Albania, Programi për Decentralizimin dhe Zhvillimin Vendor (dldp)
Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Shqipëri
URBAPLAN, Zvicer

Financuar nga: SDC – Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim

Guri i Zi - 2008

Realizimi Grafik: CREOstd

Shtypur në: Botime AFROJDIT



Schweizerische Eidgenossenschaft Swiss Cooperation Office Albania
Confédération suisse
Confeferazione Svizzera
Confederaziun svizra

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	4
Fjala e Përshëndetjes	5
Çfarë është dhe Çfarë Përfaqëson PSZH për Komunën Guri i Zi?	6
Profili i Komunës Guri i Zi	7
Komuna Guri i Zi në Kontekstin Rajonal	9
Drejtimet e Zhvillimit nga Grupi i Qytetarëve	10
Vizioni i Zhvillimit të Komunës Guri i Zi	11
Objektivat e Përgjithshëm të Zhvillimit të Komunës Guri i Zi	11
Zhvillimi Ekonomik i Komunës	12
Menaxhimi i Tokës	13
Përmirësimi i Infrastrukturave dhe Shërbimeve	14
Forcimi i Qeverisjes së Mirë	15
Mobilizimi i Burimeve Financiare	15
Instrumentat e Menaxhimit të Territorit	16
Forma dhe Metodologjia e Zbatimit të PSZH	20

Hyrje

Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës Guri i Zi, vjen në kuadër të **Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)** në rajonin e Shkodrës, që po zbatohet nga Intercooperation Albania.

Komuna Guri i Zi është një ndër tetë njësitë partnere të qeverisjes vendore përfituese të këtij programi, krahas Bashkive Shkodër, Vau i Dejës, Pukë, Fushë-Arrëz, Koplík si dhe Komunave Velipojë e Dajç.

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal në Rajonin e Shkodrës, i cili është në fazën e parë të zbatimit të tij (2006 – 2009) është financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatuar nga Intercooperation Albania (organizatë zvicerane jo fitimprurëse që operon në rajonin e Shkodrës). Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, me qendër në Tiranë, u kontraktua me cilësinë e ekspertit vendas për të asistuar gjashtë njësitë e qeverisjes vendore në rajonin e Shkodrës, përkatësisht Bashkitë Koplík, Vau i Dejës, Pukë, Fushë Arrëz si dhe Komunitat Dajç e Guri i Zi, në përgatitjen e dokumenteve të tyre të zhvillimit të tillë si Planet Strategjike të Zhvillimit dhe po ashtu Planet e Përgjithshme Rregullues për Bashkitë Vau Dejës e Koplík në përputhje me termat e referencës për secilën prej tyre.

Hartimi i Planit Strategjik të Zhvillimit për çdo njësi vendore të përfshirë, nëpërmjet një procesi përgatitor me pjesëmarrjen e qytetarëve, përbën boshtin kryesor të programit. Qëllimi i tij është pajisja e autoriteteve vendore me një dokument bazë strategjik, i cili identifikon prioritetet kyçe të zhvillimit për njësinë vendore si dhe propozon format e zhvillimit në aspektin ekonomik, përmirësimin e infrastrukturave fizike dhe sociale, shpërndarjen e shërbimeve publike, planifikimin dhe menaxhimin e territorit.

Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës Guri i Zi është përshtatur, pasuruar dhe pjekur përgjatë një procesi të hapur pjesëmarrjeje, i cili ka vënë në lëvizje strukturat vendore, grupin e qytetarëve të përfshirë në cikle seminaresh debatuese dhe konsultative të hapura për të gjithë komunitetin vendas në çdo fazë të hartimit të planit.

Në këtë grup u përfshinë përfaqësues të administratës së Komunës, Këshillit Vendor të saj, grupe të ndryshme interesi (biznese, emigrantë, fermerë, etj), përfaqësues të Qarkut të Shkodrës si një partner i rëndësishëm në zbatimin e mëtejshëm të këtij dokumenti, përfaqësues të organizatave jo-fitimprurëse (OJF) apo organizatave me bazë komunitare.



Fjala e Përshëndetjes



Ideja për të hartuar një Plan Strategjik Zhvillimi për Komunën tonë ka qenë e kahershme. Që në fillim të vitit 2002 është hartuar dhe prezantuar në Forumin Rural një draft për drejtimet e zhvillimit strategjik të Komunës Guri i Zi në të ardhmen. Duhet theksuar, se pjesërisht për shkak të mungesës së përvojës, apo për shkak të kapaciteteve të kufizuara, përmbajtja e materialit të paraqitur në Forum kishte disa mangësi.

Për këtë arsye, një nga kërkesat e para të Komunës gjatë krijimit dhe konsolidimit të bashkëpunimit me organizatën zvicerane Intercooperation Albania, ishte pikërisht vazhdimi dhe finalizimi i kësaj nisme.

Sot, me kënaqësi konstatojmë realizimin e kësaj kërkesë dhe domosdoshmërie për Komunën tonë, mbi të gjitha në saje të punës së përkushtuar dhe mjaft cilësore të grupit të ekspertëve të Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, të mbështetur në mënyrë të vazhdueshme dhe frytdhënëse nga Intercooperation Albania

Dëshiroj të përgëzoj angazhimin qytetar të Grupit të Komunitetit Vendor në Komunë, të cilët dhanë një kontribut të vyer për realizimin e këtij plani të rëndësishëm ambicioz. Përshëndes në këtë mënyrë grupet tematike të zhvillimit bujqësor dhe blegtoral, grupin e zhvillimit mjedisor, turizmit, grupin e çështjeve sociale etj.

Me këtë rast, shpreh angazhimin serioz të komunës Guri i Zi, për kthimin e Strategjisë së Zhvillimit në një busull orientimi për një zhvillim të përbashkët në vitet në vazhdim.

Me respekt!

BROZ MARKU
Kryetari i Komunës Guri i Zi

Çfarë është dhe Çfarë Përfaqëson PSZH për Komunën Guri i Zi?

Një plan novator; për të parën herë Komuna Guri i Zi ka një Plan Strategjik Zhvillimi duke hapur rrugën për një përjasje më të organizuar si edhe planifikuar të orientuar drejt zhvillimit të saj.

Një plan produkt dhe proces; ky Plan Strategjik Zhvillimi si një mekanizëm institucional shërben për rritjen e mirëqenies të të gjithë banorëve të Komunës Guri i Zi, si edhe përcakton axhendën vendiore të zhvillimit të zonës. Ajo çka e bën të veçante është së ky plan nuk është thjesht një produkt, por mbi të gjitha një proces, i cili mundëson formësimin e të ardhmes dhe adresimin e nevojave të komunitetit të Komunës Guri i Zi për të arritur qëllimet e tyre.

Plani evidenton politikat në nivel vendor dhe aktivitetet zhvilluese në të ardhmen, ndërkohe është i bazuar në nevojat, përparësitë dhe potencialet ekzistuese, të cilat janë evidentuar dhe diskutuar përgjatë një procesi të gjatë konsultash si me qytetarët ashtu edhe me grupin e punës të autoriteteve vendore.

Një plan vizionar; plani i Komunës Guri i Zi për të parën herë i përgjigjet ndjesisë vizionare të komunitetit të tij në lidhje me zhvillimin. Nisur nga fakti se konteksti shqiptar edhe pse duke njohur rëndësinë e eksperiencave në fushën e hartimit të dokumenteve strategjike si në nivelin rajonal ashtu dhe në atë kombëtar, përsëri ka munguar një ndërthurje vizionare të tyre për të shpjeguar se ku dhe si do të orientohen potencialet ekzistuese. Ky plan i bashkëngjitet me një ekuilibër më të arrirë zhvillimit rajonal duke mundësuar zhvillimin në maksimum në të gjitha fushat përkatëse. Të gjitha veprimet e propozuara i shkojnë për shtat vizionit të dëshiruar në të ardhmen për këtë Komunë si një qendër shume e rëndësishme bujqësore për rajonin e veriut.

Një plan pragmatist; Plani Strategjik i Zhvillimit është konceptuar si një kontratë aksionesh midis autoriteteve dhe qytetareve, e cila krijon vizionin e përbashkët për zonën e Gurit të Zi, specifikon llojin, sasinë dhe cilësinë e zhvillimit të nevojshëm për përmbushjen e vizionit dhe kërkon të mbrojë me çdo kusht mjedisin dhe vlerat. Ndërkohe plani është i fokusuar të ndërtojë një kuadër pune si për të filluar ashtu dhe për të influencuar procesin e ndryshimit në Komunë, me qëllim mbështetjen e objektivave të gjëra ekonomike, sociale dhe mjedisore të komunitetit të Gurit të Zi.

Një plan i përditësuar dhe realist; ky dokument është i pajisur me një portofol hartash, të cilat do të shërbejnë për të lehtësuar procesin e menaxhimit të territorit, si edhe foto imazhe të ndryshme që pasqyrojnë kushtet aktuale në vend dhe zhvillimin.



Profili i Komunës Guri i Zi



Komuna Guri i Zi shtrihet në pjesën juglindore të qytetit të Shkodrës, përgjatë rrugës rajonale Shkodër- Vau i Dejës. Ajo kufizohet me komunat Postrribë, Shllak, Bushat dhe Bërdicë. Komuna Guri Zi përfshin në territorin e vet 11 fshatra, përkatësisht: Guri i Zi, Juban, Rragam, Vukatanë, Rrenc, Sheldi, Ganjollë, Gajtan, Mazrrek, Shpor, dhe Kuç. Në këtë territor jeton një popullsi prej rreth 11 800 banorësh (3000 familje), në një sipërfaqe rreth 81.7 Km². Dendësia mesatare e popullsisë është 69 banorë për km², por shpërndarja e saj në territor nuk është e balancuar në raport me shtrirjen gjeografike duke qenë një pjesë e mirë e popullsisë.

Ndryshimet e dendësisë së banorëve në fshatrat kanë ardhur duke u theksuar sidomos pas viteve '90 me lëvizjen e lirë të njerëzve dhe vështirësitë e krijuara për përballimin e jetesës, në veçanti të mungesës së infrastrukturës dhe shërbimeve bazë. Duke qenë e vendosur ndërmjet dy stacioneve hekurudhore Mjedë dhe Shkodër, Komuna përshkohet në drejtimin veriperëndim - juglindje nga linja hekurudhore veriore e Shqipërisë, e cila përshkon 6 fshatra perëndimore të Komunës me një përfshirje prej 2/3 të popullsisë totale.


Komuna zotëron pasuri të mëdha hidrike, kjo shpjegohet pasi pjesa më e madhe e këtij kufiri të saj shtrihet në Liqenin Artificial të Vaut të Dejës, i cili ndodhet në lartësinë 74 m mbi nivelin e detit me thellësi maksimale 52 m dhe ka një sipërfaqe totale prej 2470 Ha. Pjesë nën administrimin territorial të komunës është 38 % ose 938 Ha. Në këtë liqen gjenden sasi të mëdha peshku të llojeve të ndryshme, ndërkohë që pozicioni i tij në këtë zonë ka ndikim pozitiv në zbutjen e klimës lokale.

Komuna Guri i Zi ndodhet midis lartësive 8 – 630 m mbi nivelin e detit, kjo për shkak të thyerjes së relievit dhe ekzistencës së tipologjisë fushore, kodrinore dhe malore në të gjithë shtrirjen territoriale të saj. Për këtë arsye identifikohen larmi të mëdha klimatike, tokësore, flore dhe faune, ndërtimi gjeologjik, relievi, hidrologjike.

Nr.	Emri	Vlera / karakteristika
1	Statusi ligjor dhe administrativ	Komunë
2	Vendndodhja	Qarku Shkodër
3	Sipërfaqja totale	81.7 km ²
4	Numri i qyteteve	0
5	Numri i fshatrave	11
6	Numri i banorëve	11, 800
7	Numri i familjeve	3000
8	Popullsia në gjendje fizike pune	55%
9	Buxheti vjetor - 2008	34,393,000 Lekë
10	Të ardhurat vendore të pritshme - 2008	8,000,000 Lekë
11	Numri i bizneseve private	850
12	Niveli i papunësisë	Nuk ka të dhëna të sakta
13	Numri i të punësuarve në sektorin shtetëror	67
14	Numri i të punësuarve në sektorin privat	Nuk ka të dhëna të sakta
15	Niveli i emigracionit	33%
16	Gjatësia totale e rrugëve	94 km
17	Numri i ndërmarrjeve publike	0
18	Numri i rrjeteve të ujësjellës kanalizimeve	3
19	Numri i të punësuarve në Komunë	28
20	Numri i institucioneve parashkollore	5
21	Numri i shkollave fillore - nëntëvjeçare	7
22	Numri i shkollave të mesme	1
23	Numri total i nxënësve	1650
24	Numri i qendrave shëndetësore	10
25	Numri i spitaleve	0
26	Numri i qendrave të këshillimit	0
27	Numri i qendrave për të moshuar	0
28	Aktivitetet kryesore ekonomike	Bujqësi & Blegtori Dyqane dhe njësi tregtare Njësi shërbimi Peshkim
29	Dokumente zhvillimi dhe strategji	Strategjia e Zhvillimit Rajonal
30	Nevojat kryesore në infrastrukturë	Përmirësimi i rrjeteve të ujësjellës kanalizimeve të fshatrave Ndërtimi i pikës së trajtimit të ujërave të zeza Përmirësimi i rrjetit rrugor të Komunës Përmirësimi i hapësirave të brendshme të fshatrave Ndërtimi i pikës inxhinierike të depozitimit të mbetjeve në Komunë



Komuna Guri i Zi në Kontekstin Rajonal



Zhvillimi i Komunës Guri i Zi padyshim që do të vlerësohet dhe rishikohet në funksion të progresit dhe ndryshimeve që priten të ndodhin në të gjithë rajonin e Shkodrës, pasi në asnjë moment Komuna nuk mund të konsiderohet e izoluar nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik dhe social. Në këtë logjikë Komuna duhet parë si pjesë e pandare dhe e rëndësishme e Rajonit verior të Shqipërisë edhe pjesë e funksionimit dhe bashkëpunimit të këtij Rajoni në lidhje me vendet e tjera fqinje si Mali i Zi dhe Kosova.

Nërkohë, post vitet 90 kanë shënuar për Qarkun e Shkodrës një rënie të përgjithshme ekonomike, shoqëruar nga një apati e progresit dhe emancipimit të jetës publike dhe vlerave shoqërore e kulturore. Në të njëjtën kohë për shkak të vijës politike të zhvilluar, ekziston një opinion në lidhje me mungesën e theksuar të vëmendjes ndaj zonës së veriut të Shqipërisë, në përgjithësi për sa i përket politikave ekonomike dhe sociale të ndjekura si edhe sigurimit të fondeve për ndërtimin e infrastrukturave dhe përmirësimin e shërbimeve bazë për popullsinë.

Në vitin 2005, Qarku Shkodër miratoi Strategjinë e Zhvillimit Rajonal Shkodër Lezhë. E bazuar në dinamikat specifike të rajonit, ritmet dhe tendencat e zhvillimeve demografike, ekonomike dhe sociale, ky dokument strategjik identifikon orientimet kryesore për përgatitjen e planeve strategjike të zhvillimit për njësitë e veçanta vendore, hartimin e projekteve të ndryshme në infrastrukturë dhe shërbime si dhe drejtimit e mundshme të zhvillimeve që çdo njësi mund të adresojë, duke u bazuar në kontekstin e vet si dhe në potencialet ekzistuese.

Strategjia Rajonale Shkodër Lezhë, i vë theksin konsolidimit të një rajoni policentrit, duke fuqizuar qendrën e saj, Shkodrën, por duke konsoliduar gjithashtu edhe bërthamat e vogla urbane në të gjithë rajonin. Sipas kësaj politike, ajo që duhet marrë në konsideratë në rastin e Gurit të Zi është krijimi i incentiveve për konsolidimin e Komunës si një qendër rurale në periferi të qytetit të Shkodrës, duke minimizuar largimin e popullsisë drejt qytetit si dhe duke rritur sa më shumë përfitimet që kjo njësi e vogël vendore krijon nëpërmjet afërsisë territoriale me të.

Një nga komponentët kryesorë të propozuar në Strategjinë e Rajonit Shkodër Lezhë është zhvillimi bujqësor dhe blegtoral i territoreve bujqësore të fushëgropës së Shkodrës, nëpërmjet riorganizimit të fermave dhe rigjallërimit të infrastrukturave të nevojshme për to. Komuna Guri i Zi ka një fond të konsiderueshëm toke bujqësorë duke krijuar kështu premisat bazë për zbatimin e komponentit strategjik rajonal.

Gjithashtu e rëndësishme në Strategji Rajonale konsiderohet zhvillimi i llojeve të ndryshme të turizmit, si turizmi historik, turizmi natyror liqenor, agro-turizmi etj. Potencialet që disponon në këtë rast Komuna Guri i Zi bëjnë të mundur që ky komponent zhvillimi të jetë tepër relevant, duke identifikuar kështu nevojën për artikulumin e ndërhyrjeve të kujdesshme dhe strategjike.

Ajo që qëndron thelbësore në Strategjinë Rajonale dhe që duhet të merret në konsiderate në dokumentin në vijim të Komunës është përcaktimi së çdo njësi vendore duhet të veprojë maksimalisht në rritjen dhe konsolidimin e potencialeve ekzistuese që ajo disponon, duke shmangur ndërhyrjet e kushtueshme dhe të paplanifikuara qartë. Në rastin e Komunës Guri i Zi, është e rëndësishme të mbahet në konsiderate potenciali natyror dhe njerëzor që ajo disponon, duke e orientuar atë nëpërmjet përcaktimeve për transformimin dhe zhvillimin e territorit.

Drejtimit e Zhvillimit nga Grupi i Qytetarëve

- orientimi i zhvillimit ekonomik në Komunë me fokus rigjallërimin dhe forcimin e aktiviteteve prodhuese bujqësore dhe blegtorale;
- riorganizimin e fermave bujqësore në Komunë duke u bazuar në mundësitë reale teknike dhe profesionale si dhe në specifikimin e mëtejshëm të produkteve bujqësore për të cilat ka nevojë tregu;
- eksplorimi i mundësive për nisma të turizmit me fokus agro-turizmin dhe turizmin natyror liqenor;
- zhvillimi i tregtisë bazuar kryesisht tek prodhimet bujqësore dhe blegtorale;

Vizioni i Zhvillimit të Komunës Guri i Zi



Guri i Zi si një qendër e rëndësishme rurale në veri të Shqipërisë, me prodhime bujqësore cilësore dhe të bollshme si për tregun vendor por në mënyrë të veçantë për tregun rajonal me qendër në Shkodër;

Guri i Zi, një bashkësi qendrash të vogla policentrike komunitare në juglindje të qytetit të Shkodrës, ku evidentohen tiparet dhe cilësitë pozitive të jetesës në një komunitet të përbashkët dhe ku mbizotëron fryma e bashkëpunimit dhe respektit reciprok midis banorëve;

Guri i Zi, me një mjedis natyror të mirëmbajtur, ku ndërthuren mrekullisht karakteristikat kodrinore të territorit, bukuritë natyrore të liqenit artificial të Vaut të Dejës si dhe fushat pjellore në perëndim;

Objektivat e Përgjithshëm të Zhvillimit të Komunës Guri i Zi

A. NË FUSHËN E ZHVILLIMIT EKONOMIK;

Zhvillim ekonomik i Komunës Guri i Zi duke u përqendruar në përmirësimin e klimës së biznesit prodhues bujqësor, promovimin e aktiviteteve vendore të sipërmarrjes, si dhe krijimin e një mjedisi tërheqës për investitorët vendas dhe të huaj

B. NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË TERRITORIT;

Identifikimin e formave për konsolidimin e qendrave urbane kryesore të fshatrave të Komunës Guri i Zi, si dhe disiplinimin e ndërtimeve të ardhshme rreth këtyre qendrave, duke krijuar dhe forcuar instrumentet e nevojshëm për menaxhimin dhe monitorimin e territoreve urbane dhe rurale.

C. NË FUSHËN E PËRMIRESIMIT TË INFRASTRUKTURËS DHE SHËRBIMEVE;

Rritja e cilësisë së shërbimeve publike dhe infrastrukturës fizike dhe sociale në të gjithë territorin e Komunës Guri i Zi.

D. NË FUSHËN E PËRMIRËSIMIT TË QEVERISJES VENDORE;

Rritja e kapaciteteve menaxhuese dhe administruese të pushtetit vendor në Komunën Guri i Zi.

F. NË FUSHËN E RRRITJES SË TË ARDHURAVE VENDORE

Rritja e kapaciteteve financiare të Komunës në funksion të rritjes së mundshme të investimeve për përmirësimin e shërbimeve dhe rolit të saj ndaj komunitetit.

Zhvillimi Ekonomik i Komunës

A1. Rivalizimi i aktiviteteve ekonomike bujqësore dhe blegtorale dhe rritja e investimeve vendase dhe të huaja

- a. Përmirësimi i sistemit të të dhënave për tokën bujqësore në Komunën Gur i Zi
- b. Përmirësimi i nivelit të informimit të fermerëve në Komunë për sa i përket çmimeve apo kërkesës për produkte bujqësore dhe blegtorale në nivel rajonal, kombëtar apo ndërkombëtar.
- c. Promovimi i krijimit të fermave të mëdha bujqësore dhe blegtorale.
- d. Promovimi i Komunës Gur i Zi si një Komunë me potenciale të mëdha për prodhimin e kulturave bujqësore dhe blegtorale
- e. Përmirësimi i infrastrukturës bujqësore

A2. Stimulimi dhe mbështetja e aktiviteteve të vogla ekonomike prodhuese përgjatë aksit kryesor rrugor të Komunës

- a. Kryerja e një vlerësimi të plote teknik lidhur me situatën dhe nevojat për investime në këtë korridor
- b. Përmirësimi i infrastrukturave dhe shërbimeve në shërbim të aktiviteteve ekonomike të korridorit kryesor rrugor në Komunë

A3. Zhvillimi i agroturizmit dhe turizmit natyror liqenor në territorin e Komunës Gur i Zi

- a. Përgatitja e profilit vendor të Komunës lidhur me këto funksione dhe shërbime të reja
- b. Identifikimi i ndërhyrjeve në rrjetet e infrastrukturës

Menaxhimi i Tokës

- B1. Mbrojtja e fondit të tokës bujqësore në Komunë dhe orientimi i zhvillimeve të ardhshme urbane drejt qendrave të propozuara përgjatë aksit kryesor rrugor të Komunës**
- Përmirësimi i sistemit të kontrollit ndaj ndërtimeve të reja në Komunë*
 - Prezantimi dhe konsolidimi i masave penalizuese si dhe njohja e komunitetit vendor me këto masa.*
 - Identifikimi i politikave fiskale të posaçme për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe orientimin e ndërtimeve në këto territore*
 - Orientimi i zhvillimeve urbane dhe ekonomike përgjatë aksit kryesor rrugor të Komunës dhe qendrave të propozuara në materialet hartografike*
 - Mbrojtja e zonave të dëmtuara apo të rrezikuara në territorin e Komunës Guri i Zi*
- B2. Kontrolli dhe menaxhimi i zhvillimeve urbane rezidenciale në Komunë**
- Promovimi dhe informimi i banorëve të Komunës lidhur me përcaktimet për mënyrën e zhvillimit të zonave urbane*
 - Rritja e Kapaciteteve të komunës lidhur me menaxhimin dhe kontrollin e territoreve urbane të saj*
 - Të stimulojë dhe të vazhdojë procesin për përgatitjen e studimeve pjesore urbane për të gjitha territoret urbane në Komunë.*
- B3. Mbrojtjen e mjedisit në Komunën Guri i Zi**
- Rritja e ndërgjegjësimit të banorëve të Komunës lidhur me çështjet e mbrojtjes së mjedisit*
 - Marrja e masave konkrete për përmirësimin e zonave të dëmtuara në territorin e Komunës*

Përmirësimi i Infrastrukturave dhe Shërbimeve

- C1. Përmirësimin e gjendjes së rrjetit rrugor në Komunën Guri i Zi duke u bazuar në përmirësimin e komunikimit të banorëve të fshatrave të ndryshëm si dhe mbështetjen ndaj aktiviteteve ekonomike.**
- Identifikimi i nevojave për ndërhyrje konkrete në infrastrukturën rrugore të Komunës Guri i Zi*
 - Hartimi i projekteve të ndërhyrjes teknike në rrjetin rrugor*
 - Kryerjen e investimeve përmirësuese për rrjetin rrugor të Komunës*
- C2. Përmirësimi i gjendjes së ujësjellësit në territorin e Komunës**
- Analiza dhe identifikimi i nevojave për furnizimin me ujë të fshatrave të Komunës Guri i Zi*
 - Përmirësimi i gjendjes fizike të rrjetit të ujësjellës kanalizimeve në territorin e Komunës*
 - Rritja e kapaciteteve menaxhuese lidhur me shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimet e ujërave*
- C3. Përmirësimi i sistemeve të kanalizimeve të ujërave të zeza**
- Rritja e mundësive financiare për të investuar në rrjetin e kanalizimeve*
 - Krijimi i kuadrit të plote teknik për rrjetin e kanalizimeve në Komunë*
- C4. Grumbullimi dhe depozitimi i mbeturinave urbane**
- Përgatitja e një plani grumbullimi dhe menaxhimi të mbeturinave urbane në territorin e Komunës Guri i Zi*
 - Identifikimi i një pike të përkohshme për depozitimin e mbeturinave për të gjithë territorin*
- C5. Përmirësimi i gjendjes fizike të shkollave dhe kopshteve në territorin e Komunës Guri i Zi**
- Identifikimi i nevojave për përmirësime fizike në shkollat dhe në kopshtet e Komunës*
 - Përgatitja e projekteve teknike për financim të mundshëm nga ana e shtetit apo e donatorëve*
 - Promovimi i forumeve vendore lidhur me mundësinë e rritjes së cilësisë së mësimdhënies në shkollat e Komunës*

Forcimi i Qeverisjes së Mirë

D1. Rritja e kapaciteteve të stafit në Komunën Guri i Zi

- a. Vlerësimi i skemës organizative të Komunës dhe identifikimi i nevojave për përmirësim
- b. Rritja e kapaciteteve teknike të stafit të administratës së Komunës

D2. Rritja e nivelit të transparencës në vendimarrjen vendore në Komunën Guri i Zi

- a. Afishimi dhe shpërndarja e informacionit lidhur me aktivitetet dhe projektet e ndërmarra në Komunë
- b. Rritja dhe promovimi i pjesëmarrjes së publikut në mbledhjet e këshillit vendor në Komunë

D3. Buxhetimi me pjesëmarrje

- a. Ngritja e kapaciteteve të administratës së komunës për organizimin e Buxhetimit me Pjesëmarrje
- b. Organizimi i aktiviteteve periodike të Buxhetimit me pjesëmarrje në Komunë

Mobilizimi i Burimeve Financiare

F1. Rritja e të ardhurave vendore të Komunës Guri i Zi

- a. Vlerësimi i saktë i mundësive reale për gjenerim të ardhurash nga taksat vendore në territorin e Komunës
- b. Rritja e efciences së shërbimeve dhe shpenzimeve në nivel Komune

F2. Promovimi dhe rritja e investimeve vendore dhe të huaja në Komunë

- a. Krijimi i një klime me të mirë për biznesin në Komunë
- b. Promovimi i burimeve, karakteristikave dhe avantazheve që ofron Komuna për investitorët
- c. Hartimi i projekt propozimeve për të mundësuar financime të ndryshme në territorin e Komunës

Instrumentat e Menaxhimit të Territorit

Në lidhje me përcaktimin dhe orientimin e shpërndarjes hapësinore të zonave të banimit, zonave mikse si dhe atyre ekonomike në Komunën e Gurit të Zi, në vijim paraqiten në këtë dokument, hartat me shpjegimet përkatëse.

Qëllimi i tyre është që të shprehin nëpërmjet organizimit të hapësirës territoriale objektivat kryesore ekonomike, sociale dhe ambientale të Komunës. Gjithashtu ato janë një instrument kyç për pjesëmarrjen e publikut, duke i ofruar qoftë aktoreve privatë apo publike mundësinë për të bashkëvepruar bazuar në një vision të qartë dhe të integruar.

Nga ana tjetër, ato do të aftësoje mobilizimin e komunitetit më tej, drejt arritjes së qëllimeve të përbashkëta.

Qëllimi kryesor i këtyre materialeve të paraqitura është të orientoje zhvillimin, parë në këndvështrimin e menaxhimit të territorit. Në rastin e Komunës së Gurit të Zi, këto instrumenta synojnë:

- ❖ Të drejtojnë përdorimin e përgjithshëm të tokës duke përcaktuar kornizat për zhvillimin territorial të Komunës Guri i Zi.
- ❖ Të përcaktojnë korridoret kryesore të transportit.
- ❖ Të përcaktojnë kategoritë e përdorimit të tokës.

A. Zonat e banimit

Zonat e banimit të paraqitura në hartë ndahen në dy lloje:

1. Në llojin e parë janë të përfshira **Zonat e Konsolidimit Urban**, të cilat kanë nevojë dhe janë subjekt për hartimin e Planeve të Përgjithshme Rregulluese në të ardhmen, të Master Planeve tematike apo Studimeve të tjera specifike (si psh Studime të Detajuara Pjesore etj...). Në të njejtën kohë këto zona kanë nevojë të plotësohen me gjithë infrastrukturën fizike dhe sociale të nevojshme për një zonë banimi dhe shërbimet përkatëse (rrjeti rrugor, sistemi i kanalizimeve, furnizimi dhe ujë dhe energji elektrike, transporti publik, shkolla, kopshte, qendra shëndetësore e sociale etj...). Dendësia e propozuar bruto në këtë zonë është 100 banore/Ha, ndërsa dendësia neto është 140 banore/Ha. Në këtë zonë propozohet të lejohen dhe inkurajohen (duke u bazuar në politikat vendore përkatëse) ndërtime të reja me qëllim konsolidimin e zonës dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve publike. Në këtë zonë bëjnë pjesë fshatrat si: Juban, Guri i Zi, Vukatana, Gajtani, Rrënci dhe Kuçi.

2. Në llojin e dytë janë të përfshira **Zonat e Ngrirjes Urbane**, të cilat nuk paraqesin nevojë për Plane të Përgjithshme Rregulluese pasi propozimi konsiston, në reduktimin dhe ndalimin e ndërtimeve të reja në të ardhmen. Në zonat e llojit të dytë janë kryesisht zona lindore e Komunës por edhe fshatrat si, Rragami e Ganjolla.

Objektivat që kanë orientuar propozimet e mësipërme janë:

- Të ndihmojnë në konsolidimin e zonës urbane.
- Të ndihmojnë në dendësimin dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve në zonën urbane
- Të ndihmojnë në uljen e kostove të investimeve dhe të mirëmbajtjes së infrastrukturave në zonën urbane e më tej.


B. Zona specifike:

Zona specifike të paraqitura në hartë:

- **Zonat ekonomike:** këtu do të nënkuptojmë zonat e destinuar për zhvillimin e tregtisë, industrisë së lehtë të përpunimit të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale të zonës dhe si dhe shërbimeve përkatëse. Këto zona janë të vendosura përgjatë rrugës kryesore të Komunës Guri i Zi, si dhe një zonë tjetër në afërsi të fshatit të Vukatanës.


Këto instrumenta të paraqitura në mënyrë skematike orientojnë studimet e sipërpërmendura në bazë të prioriteteve dhe të planeve të veprimit siç përcaktohen në këtë Plan Strategjik të Zhvillimit.

PLANI STRATEGJIK KOMUNA GURI I ZI



Instrumentat e Menaxhimit te Tokes

KUFIRI ADMINISTRATIV I KOMUNES GURI I ZI



Legjenda

Zonat qe do te Plotesohen me Studime Urbane & Projektet e Infrastrukturave
(Studime Urbane, Plane Peregjuesore, Studime Pjesore, Dizajn Urban etj.)



Zonat qe do te jene ne Ngrirje



Zonat qe do te Plotesohen me Projekte te Detajuara te Dizajnit Urban



KOMUNA GURI I ZI



EUROPEAN
cooperation



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

PLANI STRATEGJIK KOMUNA GURI I ZI

Propozime per Nderhyrje
ne Rrjetin Rrugor



LEGJENDA

- ZONA BANIMI
- RRUGET NE BRENDESI TE FSHATRAVE
- RRUGET LIDHESE MËS FSHATRAVE



KOMUNA GURI I ZI




Shërbimet e Planifikimit dhe Organizimit të Territorit
Qendër Kombëtar i Planifikimit dhe Organizimit të Territorit

Forma dhe Metodologjia e Zbatimit të PSZH

Komuna Guri i Zi, nëpërmjet Kryetarit dhe administratës vendore, janë përgjegjësit kryesorë për zbatimin e Planit Strategjik të Zhvillimit. Për të rritur eficiencën e këtij procesi është e nevojshme marrja e masave si më poshtë:

- Të ngrihet grupi i zbatimit dhe monitorimit të Planit Strategjik të Zhvillimit të Komunës Guri i Zi, brenda strukturës administrative ekzistuese, i cili do të jetë përgjegjës kryesor për koordinimin dhe zbatimin e nismave dhe aktiviteteve të propozuara në Planin e Veprimit. Në varësi të buxhetit të Komunës, grupi mund të përbëhet nga përfaqësues të zyrave të ndryshme të administratës apo edhe nga specialistë të angazhuar rishtazi në këtë strukturë. Në të dy rastet, grupi duhet të jetë nën udhëheqjen e Kryetarit të Komunës. Në këtë mënyrë sigurohet vazhdimësia dhe lidhja e Planit Strategjik të Zhvillimit me proceset e planifikimit dhe buxhetimit vjetor.
- Konsolidimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve të Departamentit të Koordinimit Zhvillimit në Komunën Guri i Zi, i cili do të angazhohet me përgatitjen e studimeve dhe Projekt Propozimeve të nevojshme për financim në funksion të aktiviteteve të propozuara sipas çdo fushe.
- Riorganizimi administrativ i Komunës Guri i Zi duke u bazuar në veprimet dhe kërkesat e identifikuara në Planin e Veprimit të propozuara si p.sh: krijimi i grupeve të punës për përgatitjen e projekt propozimeve, organizimi dhe monitorimi i seminareve apo takimeve me pjesëmarrjen e aktorëve vendorë për çështje të buxhetimit, arsimit, bujqësisë, mjedisit, etj; organizimi dhe moderimi i “shoqërive funksionale” në bashkëpunim me njësite vendore fqinje etj
- Fokusimi në forcimin e strukturave administrative që merren me ndjekjen e angazhimeve strategjike në kuadër të Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe monitorimin e performancës.
- Përmirësimi i bazës së të dhënave territoriale, financiare dhe infrastrukturore në Komunë për t’i paraprirë përgatitjes së një serie projektesh apo studimesh të nevojshme për zbatimin e mundshëm të Planit Strategjik të Zhvillimit.



- Rritja e kapaciteteve dhe nivelit të angazhimit të stafit të Komunës Guri i Zi sidomos në aspektin e menaxhimit dhe monitorimit të territorit dhe infrastrukturave fizike nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme apo edhe përmirësimit të sistemit të raportimit dhe vlerësimit.
- Institucionalizimi i raporteve periodike të çdo zyre të administratës lidhur me ecurinë e zbatimit të Planit Strategjik të Zhvillimit.

Zbatimi i suksesshëm i Planit Strategjik të Zhvillimit në Komunën Guri i Zi ka nevojë për konsolidimin e një sistemi të mirëfilltë monitorimi dhe vlerësimi periodik. Në këtë mënyrë bëhet e mundur evidentimi i problemeve që mund të hasen gjatë zbatimit të Planit të Veprimit si dhe të përcaktohen ndryshimet apo adaptimet e nevojshme. Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës i referohet një periudhe të shkurtër kohore 2008 – 2014, dhe në këtë mënyrë është tepër e rëndësishme që të shoqërohet me një proces të vazhdueshëm vlerësimi dhe përshtatjesh të nevojshme.

Duke qenë së Plani është një dokument strategjik në shërbim të Komunës Guri i Zi, është e natyrshme që zbatimi dhe monitorimi i tij të kryhet sipas proceseve të funksionimit dhe planifikimit të pushtetit vendor. Kjo mund të thuhet edhe për sinkronizimin e aktiviteteve të propozuara me fazat elektorale të zgjedhjes së pushtetit vendor në Shqipëri. Në këtë mënyrë sigurohet edhe përshtatja e propozimeve të Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe monitorimi i zbatimit të tij me ciklet e planifikimit vjetor dhe buxhetimit të administratës.

Bazuar në Ligjin për Financat Publike, përgatitja e Projekt Buxhetit për tre vitet në vazhdim, është një proces që duhet të finalizohet në muajin Korrik të çdo viti. Ky projekt buxhet bazohet në Udhëzimin e Qeverisë për përgatitjen e projekt buxhetit të të gjitha njësive vendore në periudhën Qershor-Korrik. Ky Projekt Buxhet parashikon shpenzimet dhe investimet e Komunës Guri i Zi për tre vitet në vazhdim, ndërsa Plan Buxheti, që përgatitet dhe miratohet nga Këshilli Vendor si dhe nga Prefektura Shkodër brenda Dhjetorit, trajton vetëm vitin pasardhës. Përgatitja e projekt investimeve për Grantet Konkurruese është një proces që duhet të përfundojë deri në 1 Nëntor të çdo viti. Plan Buxheti vjetor mund ose jo të përfshijë këto projekte në strukturën e tij.

Skema e propozuar e monitorimit të Planit Strategjik të Zhvillimit

Aktiviteti i propozuar	Afati kohor (për çdo vit)	Aktorët përgjegjës	Lidhja me planifikimin dhe buxhetimin vjetor
Vlerësimi 6 mujor i aktiviteteve të Planit të Veprimit të PSZH; Përgatitje e Progres Raportit	Prill - Maj	Njësia e Koordinimit dhe Zhvillimit.	Duke u bazuar në rezultatet e 6 mujorit, Komuna mund të përcaktojë ndryshimet në Projekt Buxhetin që dorëzohet në korrik.
Takime publike me qytetarët për rezultatet e zbatimit të PSZH.	Qershor - Korrik	Njësia e Koordinimit dhe Zhvillimit.	Ndikojnë në adoptimet e nevojshme të aktiviteteve në Plan Buxhetin final.
Takim i stafit të administratës së Komunës për të diskutuar progresin si dhe ndryshimet e nevojshme.	Tetor - Nëntor	Njësia e Koordinimit dhe Zhvillimit – Kryetari i Komunës	Takimi do të finalizojë ndryshimet dhe adoptimet e nevojshme të Planit të Aktiviteteve që do të reflektohen në Buxhetin e ri vjetor të dhjetorit.
Takim vjetor për vlerësimin dhe monitorimin e PSZH; Përgatitje a raportit vjetor.	Nëntor	Njësia e Koordinimit dhe Zhvillimit – Kryetari i Komunës.	Takimi final i paraprin finalizimit dhe dorëzimit të Buxhetit Vjetor të Komunës.

Në fund të çdo vlerësimi, Grupi i Punës duhet të dorëzojë një raport përmbledhës i cili do të paraqitet para Këshillit të Komunës Guri i Zi. Ky i fundit, ruan të drejtën që për çdo rast, të bëjë kërkesë për raportim shtesë nëse e gjykon të nevojshme.

PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË KOMUNËS GURIZI

P ë r m b l e d h j e